



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenje Sociale
06 Nr. *020.48837*, dt. *10.11.2020*



Në vështrim të nenit 8 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet, dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në bazë të Vendimit Nr. 01/400-45870, të dt. 23.10.2020 për Shpalljen e Thirrjes Publike, gjithashtu bazuar në Thirrjen Publike për Aplikim Nr 06-400/01-46254, të dt. 20.10.2020, Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenje Sociale bënë këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM
Për themelimin e komisionit Vlerësues për mbështetje financiare të programeve/projekteve të OJQ-ve

Ftohen dy (2) përfaqësues në cilësinë e ekspertëve të jashtëm të fushës së OJQ-ve, të aplikojnë për Komision Vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare nga Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale (OMF).

Disa nga detyrat e Komisionit Vlerësues janë:

1. Të vlerësojë aplikacionet nga aspekti procedural sipas procedurës së përcaktuar të nenit 17 të kësaj Rregulloreje dhe vendos nëse aplikantët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje për tu kualifikuar për mbështetje financiare publike.
2. Të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikacionet /propozimet e aplikantëve të kualifikuar për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtësor, sipas kriterëve të nenit 18.
3. Të kërkojë dokumentacion shtesë të nevojshëm nga aplikuesit pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës
4. Të përzgjedhë përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike

Thirrja Publike është e hapur pesë (5) ditë nga dita e publikimit në web faqen e Komunës së Drenasit. Aplikacionet mund të dorëzohen në sportelin e objektit të komunës

Dokumentacioni që duhet dorëzuar:

Dokument identifikimi, kualifikimi dhe Kontrata e Punës apo Vertetimi që është pjesë e punës së OJQ-ve apo Shoqërisë Civile



Drejtori i DSHMS-së
[Signature]
Dr. Arsim Haxhiu